

RAIFFEISEN PRESTIGJ

Pasqyrat financiare
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(me raportin e Audituesit të pavarur)

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur

i-iii

Pasqyrat Financiare

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

1

Pasqyra e pozicionit financiar

2

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto

3

Pasqyra e flukseve monetare

4

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

5-25

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Këshillin Administrues të “Raiffeisen Invest” sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, “Raiffeisen Prestigi” (këtu e më poshtë i referuar si “Fondi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 dhjetor 2022, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto të fondit të investimit për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më datë 31 dhjetor 2022, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA”-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare” të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Fondi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi “BKSNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi në përputhje me Nenin 120 të Ligjit nr. 56/2020 për “Investimet e sipërmarrjeve kolektive”, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit të pavarur. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj opinionit në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në të ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit të Investimeve për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Fondin e Investimeve ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi.

Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Deloitte Audit Albania SHPK

Deloitte Audit Albania SHPK

Rruga e Kavajes, ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina H

Kati i dytë, Tiranë, Shqipëri

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara
Partner Angazhimi
Audituesi ligjor

24 mars , 2023
Tiranë, Shqipëri

Raiffeisen Prestigj

Pasqyra e Të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të ardhura			
Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	10	1,352,999	1,481,387
		<u>1,352,999</u>	<u>1,481,387</u>
Shpenzime			
Tarifa e Shoqërisë së Administrimit	16	(467,701)	(548,248)
Shpenzime të tjera		(48,369)	(5,643)
Fitimi nga vlerësimi i instrumenteve financiare	8 (c)	36,620	36,175
		<u>(479,450)</u>	<u>(517,716)</u>
Totali i të ardhurave neto		<u>873,549</u>	<u>963,671</u>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Ndyshimi në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura në vlerën e drejte nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	11	(2,418,235)	81,569
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave		<u>(1,544,686)</u>	<u>1,045,240</u>

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Raiffeisen Prestigj

Pasqyrat e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVET			
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpëfshirëse	12	22,000,975	42,454,137
Paraja dhe ekuivalentë të saj	13	4,139,902	4,623,778
TOTALI I AKTIVEVE		26,140,877	47,077,915
DETYRIMET			
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit		26,287	45,643
Detyrime ndaj mbajtësve të kuotave për tërheqje		69,593	55,033
Detyrime të tjera	14	33,681	15,452
TOTALI I DETYRIMEVE		129,562	116,128
AKTIVET NETO QË I ATRIBUOHEN MBAJTËSVE TË KUOTAVE	15	26,011,315	46,961,787
Numri i kuotave të emetuara të Fondit (Në mijë)	15	17,222	29,829
AKTIVET NETO PËR NJËSI NË LEK		1,510	1,574

Shënimet në faqet 5 deri në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli i Administrimit të Raiffeisen INVEST – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. më 20 mars 2023.

Administratore e Përgjithshme

Znj. Edlira KONINI

**Zv. Administratore e Përgjithshme**

Znj. Alketa EMINI

Raiffeisen Prestigj

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar			
Kontribute		46,961,787	42,110,544
Tërheqje për pagesat e kuotave	15	4,669,655 (24,075,440) (19,405,785)	11,063,599 (7,257,596) 3,806,003
Rritja në aktivet neto nga mbajtësit e kuotave		873,549	963,671
Humbje (Të ardhura) të tjera gjithëpërfshirëse		(2,418,235)	81,569
Rritje neto		(1,544,686)	1,045,240
Aktive neto nga mbajtësit e kuotave	15	26,011,316	46,961,787
NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT NË MIJË			
Të emtuara bazuar në kontribute		2,969	7,102
Të tërhequra nga mbajtësit e kuotave		(15,576)	(4,670)
RRITJE NË NUMRIN E KUOTAVE TË FONDIT		(12,607)	2,432

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Raiffeisen Prestigj

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	2022	2021
Fluksi monetar nga aktiviteti operativ			
Të ardhura neto		873,549	579,523
<i>Rregullime për:</i>			
Fitimi nga vlerësimi i instrumenteve financiare	8 (c)	(36,620)	347,974
Të ardhura nga interesi	10	(1,352,999)	(1,481,387)
		(516,070)	(553,890)
<i>Ndryshime në :</i>			
Aktive financiare të matura me VDATGJ		17,597,133	(4,242,618)
Të pagueshme ndaj Shoqërise Administruese	16	(19,356)	771
Detyrime të tjera	14	18,229	14,002
		17,079,936	(4,781,735)
Interesi i marrë		1,457,765	1,467,814
Paratë neto nga aktiviteti operativ		18,537,701	(3,313,921)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet financues:			
Kontribute të arkëtuara nga mbajtësit e kuotave	8 (c)	4,669,652	11,063,597
Kontribute të paguara mbajtësve të kuotave	8 (c)	(23,691,230)	(7,106,288)
Paratë neto nga aktiviteti financues		(19,021,578)	3,957,309
Rënia(rritja) neto e parave dhe ekuivalentëve me to		(483,876)	643,387
Paraja dhe ekuivalentë të saj në fillim të vitit	12	4,623,778	3,980,391
Paraja dhe ekuivalentë të saj në periudhën e raportimit	12	4,139,902	4,623,778

Shënimet në faqet 5 deri në 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Fondi i Investimit Raiffeisen Prestige (“Fondi”) është një fond investimi me ofertë publike i licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (“AMF”) bazuar në Ligjin Nr. 10198, më datë 10 Dhjetor 2009 “Per Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe mbi vendimin nr. 180 më datë 13 Dhjetor 2011.

Aktivitetet investuese të Fondit administrohen nga Raiffeisen INVEST- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. (“Shoqëria Administruese”).

Objektivi i Fondit është maksimizimi i kthimit të investimit duke ruajtur kapitalin dhe likuiditetin. Fondi synon të arrijë këtë objektivi duke tregtuar një portofol i cili përbëhet kryesisht nga instrumenta borxhi të Qeverisë Shqiptare.

Të ardhurat nga investimi në Fond janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe lidhen me të ardhurat kapitale të mbajtësve të kuotave të cilët taten me një normë prej 15%. Shoqëria Administruese ushtron funksionin e agjentit mbledhës për llogari të Fondit.

Fondi ofron kuotat e tij drejt një numri të madh investitorësh, kryesisht individë.

Bazuar në Ligjin Nr. 10197, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare miratoi gjithashtu First Investment Bank Albania sh.a. si Bankë Depozitare e Fondit të Investimit Raiffeisen Prestige (“Depozitari”). Shoqëria Administruese dhe Depozitari mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj.

Bordi i Administrimit është organi qendror i Fondit dhe përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

Znj. Donalda GJORGA	Kryetar
Z. Peter ZILINEK	Zv.kryetar
Z. Erjon BALLI	Anëtar
Znj. Alda SHEHU	Anëtar
Znj. Gentjana CICERI	Anëtar
Znj. Edlira KONINI	Anëtar
Znj. Alketa EMINI	Anëtar

Administratorët:

Znj. Edlira KONINI	Administratore e Përgjithshme
Znj. Alketa EMINI	Zv. Administratore e Përgjithshme

2. Bazë e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të fondit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”). Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë të miratuara nga Drejtimi i Shoqërisë më datë 20 mars, 2023.

2.2. Parimi i vijimësisë

Ecuria e aktiveve të fondit dhe kthimi nga investimi

Sipas raportimit për tremujorin e katert të vitit 2022 për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, vlera neto e aktiveve të fondit Raiffeisen Prestigj, ka pësuar një ulje prej 44.61% krahasuar me vlerën më 31 dhjetor 2021, ndërsa numri i kuotave është ulur përkatësisht me 42.26%, duke shënuar një normë kthimi totale për fondin prej -4.07% (31 dhjetor 2021: 0,36%). Referuar investimeve të lidhura me Fondin Raiffeisen Prestigj, struktura e investimeve përbëhet nga instrumente të mbajtura në VDNAGJ.

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)**2.2. Parimi i vijimësisë (vazhdim)****Ecuria e likuiditetit**

Sipas raportimit për tremujorin e fundit të vitit 2022 për Autoritetin e Mbikëqyrësit Financiar, rezerva e likuiditetit (niveli i kërkuar i Pasurive likuide të Cilësisë së Lartë ALCL) është më e lartë krahasuar me vlerën më të lartë midis 15% të vlerës së aktiveve neto të fondit. Në këto kushte fondi është mbi kufijtë e kërkuar të likuiditetit sipas kërkesave të rregullores për administrimin e likuiditetit për fondin e investimit, duke qenë në gjendje të përmbushë kërkesat e ripagimit, detyrimet ligjore dhe detyrimet e tjera ndaj imazhit të investitorëve. Fondi mban një nivel të pasurive likuide të portofolit të investimeve në mjete monetare dhe bonot thesarit (brenda vendit) 21.2% të totalit të aktiveve, në varësi të kushteve të tregut dhe aksesit sipas strategjisë afat-mesme të fondit. Për tremujorin e fundit të vitit 2022, fondi kishte një nivel në ulje të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to krahasuar me mbylljen e vitit 2021.

Prova e rezistencës

Shoqëria kryen provat e rezistencës për të përllogaritur likuiditetin e nevojshëm në rastin e skenarëve të përkeqësuar të tregut. Në vijim ajo ka përcaktuar raportin e likuiditetit në varësi të tërheqjeve neto që parashikohen gjatë një skenari të përkeqësuar për një periudhë javore për ekspozimet e mëdha dhe tremujore për ekspozimet mesatare. Në analizë merret parasysh dhe koha e nevojshme për shlyerjen e investimeve për të përballuar flukset e pritshme dalëse. Në baze të supozimeve të skenarit të analizuar, vlerësohet se fondi mund të arrijë të përballojë vështirësitë e mundshme të supozuara, duke qenë në përputhje edhe me kufizimet rregullatore në lidhur me likuidimet brenda afatit ligjor, nga ku vlerësohet se periudha minimale e mbulimit të flukseve është 3 muaj. Bazuar në analizat e mësipërme, Drejtimi ka siguri të mjaftueshme se nuk ekzistojnë pasiguri materiale, që mund të hedh dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Fondit për të operuar sipas parimit të vijimësisë në të ardhmen e parashikeshme. Për këtë arsye, përgatitja e pasqyrave financiare sipas parimit të vijimësisë konsiderohet e përshtatshme më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale për Fondin.

4. Bazat e matjes

Keto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç instrumentave financiare jo-derivative të mbajtura në VDNAGJ të cilët janë matur me vlerën e drejtë.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, drejtimi i Fondit ka kryer gjykime dhe vlerësime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet. Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Gjykime dhe vlerësime

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira në shënimet e mëposhtme:

- Shënimi 7 (c) – klasifikimi i aktiveve financiare: vlerësimi i modelit të biznesit në të cilin aktivitet mbahen
- Shënimi 8 – zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen;
- Shënimi 9 – përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare me të dhëna kryesisht të pavrojtueshme

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Statusi i entitetit vlerësues

Në përcaktimin e statusit të Fondit si një njësi ekonomike investuese në përputhje me SNRF 10, Shoqëria Administruese konsideroi si në vijim:

- a) Fondi ka grumbulluar mjete monetare nga një numër investitorësh për të rritur vlerën e aktiveve të Fondit dhe për t'i ofruar investitorëve shërbime menaxhuese nëpërmjet investimit në letra me vlerë ose të tjera;
- b) Fondi ka për qëllim gjenerimin e kthimeve kapitale dhe të ardhura nga investimet e tij, të cilat, nga ana e tyre, do të shpërndahen në përputhje me kërkesat për mbajtësit e njësisë; dhe
- c) Fondi vlerëson performancën e investimeve të tij në bazë të vlerës së drejtë (përveç atyre të klasifikuara si të mbajtura për të arketuar), në përputhje me politikat e paraqitura në këto pasqyra financiare. Edhe pse Fondi i plotësoi të tre kriteret përcaktuese, Shoqëria Administruese ka vlerësuar gjithashtu qëllimin e biznesit të Fondit, strategjitë e investimit për investimet e kapitalit privat, natyrën e çdo fitimi nga investimet e kapitalit privat dhe modelet e vlerës së drejtë. Shoqëria Administruese e bëri këtë vlerësim me qëllim që të përcaktojë nëse ekzistojnë fusha të tjera të gjykitimit në lidhje me karakteristikat tipike të një njësie investuese kundrejt atyre të Fondit.

6. Standarde të reja dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

(a) Standardet e reja të përshtatura më 1 janar 2022

Standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë në fuqi për periudhën aktuale të raportimit:

- Ndryshimet në dispozitat e SNK 37- Provizionet, Detyrimet dhe Aktivitetet e Kushtëzuara—Kontratat e rëndësishme—Kostoja e përmbushjes së një kontrate- Data e hyrjes në fuqi fillon më ose pas 1 janarit 2022, me aplikimin e hershëm të lejuar
- Përmirësimet vjetore në standardet e SNRF 2018-2020- Ndryshimet në SNRF 1, Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë, SNRF 9 Instrumente financiare, SNRF 16 Qiratë, dhe SNK 41 Bujqësia- Data efektive fillon në ose pas 1 janarit 2022, me aplikim të hershëm të lejuar.
- Ndryshimet në SNRF 3- Kombinimet e Biznesit- Referencë për Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar . Efektive duke filluar nga ose pas 1 janarit 2022- me aplikim të hershëm të lejuar.
- Ndryshimet në SNK 16- Aktivitet Afatgjatë Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) — Të ardhurat para përdorimit të synuar. Data efektive fillon më ose pas 1 janarit 2022, me aplikim të hershëm të lejuar.
- Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet financiare”- Ndryshimi sqaron se me zbatimin e testit '10 për qind' për të vlerësuar nëse duhet të çregjistrohet një detyrim financiar, një njësi ekonomike përfshin vetëm tarifën e paguara ose të marra ndërmjet njësisë ekonomike (huamarrësit) dhe huadhënësit, duke përfshirë tarifën e paguara ose të marra nga njësia ekonomike ose huadhënësi në emër të tjetrit.

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nuk janë bërë shënime shpjeguese.

6. Standarde të reja dhe interpretime në publikim Akoma jo në fuqi (vazhdim)

b) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe/ose nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja ishin në fuqi, por nuk janë ende efektive:

- SNRF 17 Kontrata sigurimi - Efektive për periudhat vjetore raportuese duke filluar nga ose pas 1 janarit 2023.
- Ndryshimet në SNRF 10- Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28- Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta —Shitja ose kontributi i aktiveve midis një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose ndërmarrjeve të përbashkëta . Data efektive nuk është caktuar ende.
- Ndryshimet në SNK 1- Paraqitja e Pasqyrave Financiare —Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale. Data efektive fillon më ose pas 1 janarit 2023.
- Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Pasqyra e Praktikës së SNRF 2- Gjykimet e materialitetit—Shpalosja e politikave të kontabël. Ndryshimet në SNK 1 janë efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2023, me aplikimin më të hershëm të lejuar dhe zbatohen në mënyrë prospektive.
- Ndryshimet në politikat e kontabilitetit të SNK 8- Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet- Përkufizimi i përlllogaritjeve të kontabilitetit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 janarit 2023 për ndryshimet në politikat e kontabilitetit dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe, me aplikim më të hershëm të lejuar.
- Ndryshimet në SNK 12 Tatimi mbi të Ardhurat—Tatimi i shtyrë lidhur me Aktivet dhe Detyrimet që dalin nga një Transaksion i Vetëm- efektiv për periudhat e raportimit vjetor duke filluar nga ose pas 1 janarit 2023, me aplikim të mëparshëm të lejuar.

Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit.

7. Përmbledhja e politika të rëndësishme kontabël**a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë ri-konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedhë të huaja që maten me vlerën e drejtë, konvertohen në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen në fitim ose humbje.

b) Të ardhura nga interesi

(i) *Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv*

Të ardhurat nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse përfshijnë interesin mbi aktivet financiare të matura me koston e amortizuar dhe VDAGJ të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv. 'Norma efektive e interesit' është norma që skanton saktësisht pagesat ose akëtimet e ardhshme të mjeteve monetare, nëpërmjet jetës së pritshme të instrumentit financiar në vlerën kontabël bruto të aktivit financiar.

'Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar' është kostoja e amortizuar e një aktivi financiar përpara se të rregullohet për çdo zbritje të pritshme nga zhvlerësimi.

INë llogaritjen e të ardhurave nga interesi, norma efektive e interesit zbatohet ndaj vlerës kontabël bruto të aktivit (kur aktivi nuk është i zhvlerësuar).

c) Instrumentet financiare

(i) *Njohja dhe matja fillestare*

Fondi njeh aktivet dhe detyrimet financiare përmes në datën e tregëtimit, e cila është data kur Fondi bëhet palë e provizionit kontraktual të instrumentit. Aktivitetet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën kur ato krijohen. Një aktiv financiar ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit.

(ii) *Klasifikimi dhe matja e mëparshme*

Aktivitetet financiare

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar ose me VDAGJ. Aktivitetet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Fondi ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivitetet financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

Mjetet monetare, depozitat dhe Marrëveshjet e Riblerjes (Repot) klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar. Depozitat dhe Marrëveshjet e Riblerjes (Repot) nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare të tyre, përveç rasteve kur Kompania ndryshon modelin e saj të biznesit për administrimin e aktiveve financiare, në të cilin rast të gjitha aktivitetet financiare të prekura riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit. Fondi çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar, ose transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin përfshihen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar ose në të cilat Fondi as nuk transferon dhe as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk ruan kontrollin e aktivit financiar.

Fondi hyn në transaksione në të cilat transferon aktivitetet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por ruan të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në këto raste, aktivitetet e transferuara nuk çregjistrohen.

Nëse kushtet e një aktivi financiar modifikohen, Fondi vlerëson nëse flukset monetare të aktivitetit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme.

Nëse flukset e mjeteve monetare janë thelbësisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar origjinal konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, aktivi financiar fillestar çregjistrohet (shih (iii)) dhe një aktiv i ri financiar njihet me vlerën e drejtë.

7. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**c) Instrumentat financiar (vazhdim)***(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme (vazhdim)*

Nëse flukset monetare të aktivitetit të modifikuar të mbajtura me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e aktivitetit financiar. Në këtë rast, Fondi rilloarit vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar dhe një shumën që rrjedh nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si një fitim ose humbje modifikuese në fitim ose humbje. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhur nga interesi (shih 7(c)).

Mjetet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të modifikohen për një sërë arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim aktual ose të mundshëm të kredisë së palës tjetër. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar mund të çregjistrohen dhe aktivi i rinegociuar të njihet si i ri me vlerën e drejtë në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në shënimin 6 (c).

Kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, përcaktimi nëse rreziku i kredisë i aktivitetit është rritur ndjeshëm pasqyron krahasimin e:

- PM e mbetur e jetës së tij në datën e raportimit bazuar në kushtet e modifikuara; me
- jetëgjatësinë e mbetur të PM-së së vlerësuar bazuar në të dhënat në njohjen fillestare dhe kushtet origjinale të kontratës.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Fondi vlerëson objektivat e modeleve të biznesit sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë sesi menaxhohet biznesi dhe si informacioni i paraqitet drejtimit. Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Fondit.

Fondi ka përcaktuar se ka një model biznesi që përfshin investimet në letrat me vlerë dhe investimet në fondet e investimeve të palistuar. Këto mjete financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, në bazë të vlerës së drejtë.

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Fondi merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Gjatë vlerësimit, Fondi konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Fondi për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme)
- Për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përlllogaritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

7. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Instrumentet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

Detyrimet financiare- Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet dhe humbjet.

Detyrimet financiare klasifikoheshin si të matura me koston e amortizuar dhe pas njohjes fillestare ato mateshin me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njiheshin në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe flukset e mjeteve monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca midis vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv financiar të transferuar apo detyrime të marra) njihet në fitim ose humbje.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si mosnjohje, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rilloget duke skontuar flukset e modifikuara të mjeteve monetare me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

(iv) Kompensimi (netimi)

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumën dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

(v) Matja e vlerës së drejtë

‘Vlera e drejtë’ është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Fondi ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyrohet rrezikun e tij të mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet “aktiv”, në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është normalisht çmimi i transaksionit - dmth. Vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Nëse Fondi përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv identik dhe as bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, i rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje mbi një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet. Fondi njeht transferta ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese, gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

7. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Instrumentet financiar (vazhdim)

(vi) Zhvlerësimi

Fondi njihet një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe e mat zbritjen në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivitetit, përveç letrave me vlerë për të cilat llogariten me HPK 12-mujore.

Shoqëria e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Shoqërisë pa masa shtrënguese nga ana e Shoqërisë siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK 12-mujore referohen si 'Instrumente financiare në Fazën 1'.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivitetit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

Matja e HPK

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që duhet t'i paguhet Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe flukseve të mjeteve monetare që Shoqëria pret të marrë).

HPK skontohen duke përdorur normën efektive të aktivitetit financiar.

Aktivitetet financiare të zhvlerësuar

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të matura me koston e amortizuar janë aktive financiare me kredit të zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet me kredit të zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset: monetare të ardhshme të vlerësuar të aktivitetit financiar. Dëshmia se një aktiv financiar shfaq kredit të zhvlerësuar përfshin të dhënat e mëposhtme të vrojtueshme:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit;
- shkelje të kontratës si dështimi ose mospagimi në afat;
- mundësinë që debitori të hyjë në falimentim ose ndonjë riorganizim tjetër financiar; dhe
- zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë për shkak të vështirësive financiare.

Në kryerjen e vlerësimit nëse një investim në letra me vlerë është me kredit të zhvlerësuar, Shoqëria konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Vlerësimin e tregut për cilësinë e kreditit, siç pasqyrohet në normat e kthimit të obligacioneve;
- Aftësinë e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për emetimin e borxhit të ri;
- Mundësinë e ristrukturimit të borxhit, duke rezultuar në humbje për mbajtësit, nëpërmjet faljes vullnetare ose të detyrueshme të borxhit; dhe
- Mekanizmat ndërkombëtarë të mbështetjes që ekzistojnë për të siguruar mbështetjen e nevojshme si 'huadhënës i fundit në radhë' për atë vend, si dhe qëllimin e reflektuar në deklaratat publike, të qeverive dhe agjencive të këtyre vendeve për përdorimin e mekanizmave të tillë. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave dhe pavarësisht nga qëllimi politik nëse ka kapacitet për të përmbushur kriteret e kërkuara.

Paraqitja e provizionit për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar

Humbjet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përvecse kur është shprehur ndryshe)

7. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Fondi nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të aktivit financiar.

d) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare mjaft likuidë me maturitet tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat janë subjekt i një rreziku jo të rëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Fondi për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

e) Të pagueshme ndaj mbajtësve të kuotave për kërkesa tërheqjeje

Të pagueshme ndaj mbajtësve të kuotave për kërkesa tërheqjeje shprehen me koston e tyre të amortizuar.

f) Kutotat e shlyeshme

Fondi emeton kuota të shlyeshme, me kërkesë të investitorit. Çdo investitor që ka bërë shlyerje të kuotave të tij, mund të ri-investojë në Fond nëpërmjet depozitimit të mjeteve monetare ekuivalente me vlerën e kuotave të kërkuara. Kuotat janë të shlyeshme çdo ditë. Në momentin e kërkesës për shlyerje, kuotat që do të shlyhen mbarten në vlerën e shlyerjes si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar të Fondit. Çmimi i kuotave të shlyeshme bazohet në vlerën neto të aktivit të Fondit për njësi në kohën kur është bërë një kërkesë e vlefshme për shlyerje.

g) Vlera Neto e Aktiveve

Vlera neto e aktiveve është e barabartë me vlerën totale të aktiveve neto minus detyrimet e Fondit. Vlera e kuotës së Fondit është e barabartë me vlerën neto të aktiveve pjesëtuar me numrin total të kuotave në datën e raportimit.

h) Tarifa e Shoqërisë Administruese

Fondi duhet t'i paguaj Shoqërisë së Administrimit një tarifë vjetore prej 1.15% (duke nisur nga 25.11.2021 - 1.15 % dhe deri në 24 Nentor 2021- 1.25%) të vlerës së aktiveve neto, si shpenzim i cili llogaritet në bazë ditore.

i) Fitimi/humbja e realizuar nga ndryshimet në vlerën e drejtë

Fitim / humbjet e realizuara njihen nga shitja e letrave me vlerë si diferencë midis çmimit të ofruar të shitjes dhe vlerës së titullit në momentin e shitjes dhe nga interesat e letrave me vlerë të maturuara të blera me prim ose skonto. Këto dallime njihen në fitim ose humbje kur ndodhin.

j) Fitimi/humbja e porealizuar nga ndryshimet në vlerën e drejtë

Fitimi ose humbja e porealizuar përfaqëson diferencën midis vlerës kontabël të një instrumenti financiar në fillim të periudhës, ose çmimit të transaksionit nëse është blerë në periudhën aktuale të raportimit, dhe vlerës së tij kontabël në fund të periudhës raportuese.

8. Administrimi i rrezikut financiar

Ky shënim paraqet informacion në lidhje me objektivat, politikat dhe proceset e Fondit për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe menaxhimin e kapitalit të Fondit.

Fondi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziqet e tregut
- rreziqet operacionale

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Pamja e përgjithshme

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare: rrezikut të tregut (duke përfshirë rrezikun e këmbimit valutor, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit.

Fondi është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve operationale të tilla si rreziku i kujdestarisë. Rreziku i kujdestarisë është rreziku i humbjes së letrave me vlerë të mbajtura në kujdestari të shkaktuar nga neglizhenca e kujdestarit. Edhe pse është vendosur një kuadër i përshtatshëm ligjor që eliminon rrezikun e humbjes së vlerës së letrave me vlerë të mbajtura nga kujdestari, në rast të dështimit të saj, aftësia e Fondit për të transferuar letrat me vlerë mund të dëmtohet përkohësisht. Programi i përgjithshëm i menaxhimit të rrezikut të Fondit kërkon të maksimizojë kthimin që vjen nga niveli i rrezikut për të cilat Fondi është i ekspozuar dhe kërkon për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi performancën financiare të Fondit.

Bazuar në Ligjin Nr. 10198, datë 10 Dhjetor 2009 “Per Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Shoqëria Administruese ka në strukturat e saj një Njësi Menaxhimi të Rrezikut, përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut dhe raportimin e tij tek Bordi i Administrimit. Politikat e menaxhimit të rrezikut të Fondit krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat ballafaqohet institucioni financiar, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqërisë, përmes standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Fondit nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale, pjesërisht ose plotësisht gjë që sjell efekt negativ në aktivet e Fondit. Ai lind kryesisht nga letrat me vlerë të mbajtura, si dhe nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj.

Bordi i Administrimit të Fondit ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kredisë për Drejtimin, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Fondit. Investimet e Fondit janë në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare dhe për këtë arsye Fondi ekspozohet vetëm ndaj rrezikut të kredisë të qeverisë shqiptare. Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpëfshirëse	22,000,975	42,454,137
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj	4,139,902	4,623,778
TOTALI	26,140,877	47,077,915

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në datën e raportimit sipas rajonit gjeografik është:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Vendase	26,140,877	47,077,915
	26,140,877	47,077,915

Cilësia kreditimit të aktiveve financiare është si më poshtë:

	Stage 1	Stage 2	Stage 3	POCI	2022 Total	2021 Total
Qeveria Shqiptare B+	22,000,975	-	-	-	22,000,975	42,454,137
Mjetet monetare, të parankuara	4,139,902	-	-	-	4,139,902	4,623,778

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë të mbajtuara në banka vendase, të cilat janë të parankuara.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në bankat tregtare në Shqipëri. Fondi zbaton një model 12-mujor të humbjeve të pritshme dhe paraqet ekspozimet me maturim afatshkurtër në përcaktimin e zhvlerësimit e parasë dhe ekuivalentëve të saj.

Investimet në letra me vlerë

Rreziku i kredisë së portofolit të letrave me vlerë të investimit vlerësohet në bazë të të dhënave historike dhe vlerësimit të aftësisë së emetuesve të ndryshëm për të përmbushur detyrimet e saj kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare në afatin e shkurtër.

Më 31 dhjetor 2022, Fondi ka njohur një provizion për zhvlerësimin në shumën 36,620 mijë Lek (2021-36,175 mijë Lek)

Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përlogaritjen e zhvlerësimit

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Shoqëria konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen.

Fondi konsideron një instrument financiar që ka pasur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose kthyes janë përmbushur.

Për ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse ka vonesë prej 30 ditësh ose më shumë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Shoqërisë.

Fondi monitoron efektshmërinë e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një ekspozim të jetë në dështim.

Me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, Fondi nuk ka aktive financiare të zhvlerësuara.

Përkufizimi i dështimit

Shoqëria konsideron që një aktiv financiar ka dështuar kur:

- i. debitori nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Shoqërisë, pa qënë nevoja për veprime nga Shoqëria të tilla si realizimi i aktiveve të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë ekspozim të tillë); ose
- ii. debitori është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material ndaj Shoqërisë. Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Shoqëria konsideron tregues:

- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;
 - sasiore- p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës; dhe
- Të dhënat e përdorura në vlerësimin nëse një instrument financiar ka dështuar dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana.

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Mjetet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të modifikohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndonjë përkeqësim aktual ose potencial të cilësisë së kreditit të kundërpartisë. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar mund të çregjistrohet dhe aktivi i rinegociuar njihet si aktiv i ri me vlerë të drejtë në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 7(a).

Kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, përcaktimi nëse rreziku i kredisë së aktivit është rritur ndjeshëm reflekton krahasimin e:

- PM-së përgjatë jetës së mbetur në datën e raportimit bazuar në kushtet e modifikuara; me
- PM-në përgjatë jetës së mbetur vlerësuar në bazë të të dhënave në njohjen fillestare dhe kushteve kontraktuale fillestare.

Matja e HPK

Investimet e letrave me vlerë

Të dhënat kryesore në matjen e HPK janë strukturat kohore të parametrave të mëposhtëm:

- probabiliteti i mospagesës (PM);
- humbja në rast (HM);
- ekspozimi në rast mospagese (EM).

Vlerësimet e PM janë vlerësime në një datë të caktuar, të cilat llogariten në bazë të të dhënave të mbledhura brenda dhe jashtë, që përbëjnë faktorë sasiore dhe cilësorë.

HM është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një default dhe vlerësohet bazuar në parametrat e llogaritur nga agjencitë e vlerësimit.

EM përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një default. Shoqëria nxjerr EM nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës duke përfshirë amortizimin. EM i një aktivi financiar është vlera e tij kontabël bruto. Vlerësimet e EM janë llogaritur në bazë të fluksit të mjeteve monetare të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritës.

Fondi mat HPK duke marrë në konsideratë rrezikun e vonesës për periudhën maksimale kontraktuale mbi të cilën ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, edhe nëse, për qëllime të administrimit të rrezikut, Shoqëria konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Shoqëria ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie.

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme monetare për të shlyer plotësisht detyrimet e tij ose mund t'i shlyejë në kushte të cilat janë materialisht jo të favorshme.

Politika e Fondit dhe qasja e menaxherit të investimeve në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe tensioni, duke përfshirë edhe shlyerjet e vleresuara të kuotave, pa shkakuar papranueshmëri humbje ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Fondit.

Fondi ka aftësinë të marrë hua në terma afatshkurtër për të arritur marrëveshjen, pas miratimit nga AMF dhe deri në një limit të përcaktuar nga ligji. Raste të tilla huamarrjesh nuk ka pasur gjatë vitit ushtrimor.

In order to manage the Fund's overall liquidity, the Management Company also has the ability to suspend redemptions if this is deemed to be in the best interest. Për të menaxhuar likuiditetin e përgjithshëm të Fondit, Shoqëria Administruese gjithashtu ka aftësinë të pezullojë rimbursimet nëse kjo konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të të gjithë zotëruesve të njësisë. Në mungesë të detyrimeve të rëndësishme financiare, Shoqëria administruese monitoron rrezikun e likuiditetit bazuar në flukse kontraktuale të skontuara të parasë. Tabela më poshtë analizon aktivet dhe detyrimet financiare të Fondit në grupimet përkatëse të maturimit në bazë të periudhës së mbetur nga data e pasqyrës së pozicionit financiar deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat në tabela janë flukset monetare kontraktuale të skontuara më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021:

	Deri 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
31 dhjetor 2022						
Aktivët						
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpëfshirëse	1,400,000	500,000	2,915,000	1,595,823	14,443,100	20,853,923
Paraja dhe ekuivalentë të parasë	4,139,902	-	-	-	-	4,139,902
Totali	5,539,902	500,000	2,915,000	1,595,823	14,443,100	24,993,825
Detyrimet						
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit	26,287	-	-	-	-	26,287
Të pagueshme ndaj tërheqjeve të kontributeve	69,593	-	-	-	-	69,593
Detyrime të tjera	33,681	-	-	-	-	33,681
Aktive neto të atrueshme ndaj mbajtësve të kuotave	26,011,315	-	-	-	-	26,011,315
Totali	26,140,877	-	-	-	-	26,140,877
Rreziku i likuiditetit	(20,600,975)	500,000	2,915,000	1,595,823	14,443,100	(1,147,052)
Akumulimi	(20,600,975)	(20,100,975)	(17,185,975)	(15,590,152)	(1,147,052)	(1,147,052)

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
31 dhjetor 2021						
Aktivët						
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpëfshirëse	1,300,000	2,869,140	4,349,520	8,510,670	23,834,623	40,863,954
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to	4,623,778	-	-	-	-	4,623,778
Totali	5,923,778	2,869,140	4,349,520	8,510,670	23,834,623	45,487,732
Detyrimet						
Të pagueshme ndaj Shoqërisë së Administrimit	45,643	-	-	-	-	45,643
Të pagueshme ndaj mbajtësve të kuotave	55,033	-	-	-	-	55,033
Detyrime të tjera	15,451	-	-	-	-	15,451
Aktive neto të atrueshme ndaj mbajtësve të kuotave	46,961,787	-	-	-	-	46,961,787
Totali	47,077,914	-	-	-	-	47,077,914
Rreziku i likuiditetit	(41,154,135)	2,869,140.00	4,349,520.00	8,510,670.00	23,834,623.08	(1,590,182)
Akumulimi	(41,154,135)	(38,284,995)	(33,935,475)	(25,424,805)	(1,590,182)	

Aktivët neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave përfaqësojnë të gjithë vlerën neto të aktiveve të fondit. Në llogaritjen e hendekut të likuiditetit supozohet se të gjithë mbajtësit e kuotave do të shlyejnë njësitë në të njëjtën kohë, gjë që ka shumë pak gjasa. Tërheqja maksimale e fondit është -4.77%.

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i Rrezikut (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut do të ndikojnë në të ardhurat e fondit ose në vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin në rrezik.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Fondi nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për shkak se nuk ka transaksione në monedhë të huaj. Fondi nuk ka marrë pjesë në transaksione me kurs këmbimi forward apo transaksione me derivativë mbrojtës deri në 31 Dhjetor 2022. Më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021, nuk ka aktive apo detyrime materiale të shprehura në monedha të ndryshme nga Lek.

Kurset e mëposhtme të rëndësishme të këmbimit janë aplikuar gjatë vitit:

Lek	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Kursi mesatar	Në datën e raportimit	Kursi mesatar	Në datën e raportimit
EUR	118.92	114.23	122.46	120.76
USD	113.15	107.05	103.52	106.54

Ekspozimi i kompanisë ndaj rrezikut të valutës së huaj më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 ishte si më poshtë:

31 dhjetor 2022	Balanca e mbartur			
	EUR	ALL	USD	
Paraja dhe ekuivalentë të saj		(shuma e përkthyer në LEK)		
	4,139,902	4,139,902		
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpëfshirëse	22,000,975	22,000,975		
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	(26,287)	(26,287)		
Detyrime ndaj mbajtësve të kuotave për tërheqje	(69,593)	(69,593)		
Ekspozimi Neto	26,044,997	26,044,996		
31 dhjetor 2021	Balanca e mbartur			
	EUR	ALL	USD	
Paraja dhe ekuivalentë të saj		(shuma e përkthyer në LEK)		
	4,623,778	4,623,778		
Aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithpëfshirëse	42,454,137	42,454,137		
Detyrime ndaj Shoqërisë së Administrimit	(45,643)	(45,643)		
Detyrime ndaj mbajtësve të kuotave për tërheqje	(55,033)	(55,033)		
Ekspozimi Neto	46,977,239	46,977,239		

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku kryesor për të cilin janë ekspozuar portofolet tregtare është rreziku i humbjes nga luhatjet në flukset e ardhshme të mjeteve monetare ose vlerat e drejta të instrumentit financiar për shkak të një ndryshimi në normat e interesit të tregut (Vlerat aktuale neto të aktiveve dhe detyrimeve). Rreziku i normës së interesit menaxhohet kryesisht përmes monitorimit të mangësive të normave të interesit. Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt mangësive të normave të interesit shoqërohet nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Fondot kundrejt skenarëve të ndryshëm standard dhe jo standard. Skenarët standard të cilët shqyrtohen në interval të rregullt përshijnë një rritje ose rënie prej 100 pbs në të gjitha kurbat e kthimeve.

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Fondit nga një rritje apo rënie e normave të interesit të tregut (duke supozuar mungesën e lëvizje simetrike për kurbat e kthimeve dhe një pozicion konstant financiar) është si më poshtë:

Normat e Interesit	Ulje 100 pbs	Rritje 100 pbs
2022		
Efekti i Fitimit/(Humbjes) së vlerësuar në mijë Lek	456,331	(456,331)
2021		
Efekti i Fitimit/(Humbjes) së vlerësuar në mijë Lek	903,896	(903,896)

(e) Administrimi i rrezikut të kapitalit

Kapitali i Fondit përfaqësohet nga aktivet neto që i atribuohen mbajtësit të kuotave. Shuma e aktivitet neto që i atribuohet mbajtësit të kuotave mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme në baza ditore, pasi Fondi i nënshtrohet investimeve dhe tërheqjeve ditore sipas gjykimit të mbajtësit të kuotës. Objektivi i Fondit përse i përket menaxhimit të kapitalit është të ruajë vazhdimësinë e tij me qëllim sigurimin e kthimit për mbajtësin e kuotës, sigurimin e përfitimeve për palët e tjera dhe ruajtjen e një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve të investimeve të Fondit. Për të ruajtur strukturën e kapitalit, politika e Fondit do të performojë si më poshtë:

- Monitorimi i nivelit të hyrjeve dhe tërheqjeve ditore në raport me situatën e likuiditetit duhet të mundesojë likuidimin e kërkesave brenda 7 ditëve nga dita e kërkesës së vlefshme.
- Shlyerja dhe emetimi i kuotave të reja duhet kryer në përputhje me ligjin dhe prospektin e Fondit. Kjo përfshin aftësinë për të kufizuar shlyerjet dhe për të kërkuar një minimum investimi në Fond. Administratorët e Shoqërisë Administruese monitorojnë kapitalin në bazë të vlerës së aktiveve neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave.

(i) Strategjia e investimit

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit Raiffeisen Prestigj mbështetet në ligjin nr. 10198 “Per Fondet e Investimit Kolektiv” dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë Administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Keshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese.

(ii) Kuadri ligjor

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Raiffeisen Prestigj nën administrimin e Raiffeisen INVEST-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. i përmbahet ligjit nr. 10198, datë 10 dhjetor 2009 “Për Sipërmarrjet e përbashkëta të investimit” dhe prospektit të Fondit.

(iii) Investimet e lejuara

Sipas rregullores, aktivet e Fondit mund të investohen vetëm në instrumentet e mëposhtëm:

- Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të Fondeve të investimit, të liçencuara sipas ligjit nr.10198, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të liçencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivative;
- other money market instruments. instrumente të tjera të tregut të parasë.

Shoqëria administruese duhet të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr.10198, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për menaxhimin e rrezikut.

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(e) Administrimi i rrezikut të kapitalit (vazhdim)***(iii) Investimet e lejuara (vazhdim)****Kufizimet e investimit dhe kufiri i lejuar***

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 20% të aktiveve të saj në depozita në të njëjtin institucion .

Fondi nuk mund të investojë më shumë se 5% të aktiveve të saj në tituj dhe instrumente të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm.

Kufiri 5%, mund të rritet deri në:

- a) 10%. Në këtë rast, vlera totale e titujve ose instrumenteve të tregut të parasë, që mban Fondi të disa emetues, ku për secilin ka investuar mbi 5% të aktiveve, nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës totale të aktiveve të fondit;
- b) 35% në rastin e titujve dhe të instrumenteve të tregut të parasë, të emetuara ose të garantuara nga qeveria dhe autoritetet vendore të Republikës së Shqipërisë, shteteve të Bashkimit Europian, shteteve të tjera të lejuara nga AMF-ja, ose nga organizma publikë ndërkombëtarë, në të cilët bëjnë pjesë një ose më shumë shtete të Bashkimit Europian;
- c) 100% me miratimin e AMF-së, nëse plotësohen disa kushteve të përcaktuara në ligjin për “Sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
- d) 25% në rastin e disa obligacioneve të veçanta, të emetuara nga institucionet kredituese të licencuara, të cilat e kanë selinë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo në një shtet të Bashkimit Europian apo të lejuara nga AMF-ja. Kur Fondi investon më shumë se 5% të aktiveve në këto lloj obligacionesh të emetuara nga një emetues i vetëm, atëherë vlera totale e këtij investimi nuk tejkalon 80% të vlerës totale të aktiveve të Fondit;

Fondi mund të investojë deri në 30 për qind të aktiveve të tij në kuota apo aksione të një forme tjetër të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Shoqeria Administruese i menaxhon aktivet e Fondit sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kapitalit dhe rrezikut të marrë përsipër. Objektivat afatgjatë për shpërndarjen e aktiveve të Fondit janë si më poshtë:

Klasa	Objektivi
Tituj të emëtuar dhe garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë	90%
Tituj të emëtuar dhe garantuar nga shtete të Bashkimit Evropian	0%
Depozita bankare	6%
Tituj të emëtuar dhe garantuar nga autoritete lokale dhe korporata shqiptare	2%
Kutota në fonde investimi	2%
Instrumente derivateve financiar	0%
Tituj të transferueshëm dhe instrumenta të tjerë borxhi të cilët tregëtohen në tregje të rregulluar në një shtet të Bashkimit Europian ose shtetet të miratuara nga AMF-ja	0%

Politika e brendshme e investimeve të Fondit.

Rreziku në investime ndërmerret vetëm nga anëtarë të Fondit dhe jo nga Shoqeria Administruese. Për të minimizuar këtë rrezik, Shoqeria Administruese ka përfshirë në strukturën e saj organizative, Komitetin e Investimeve, i cili propozon politikat për alokimin e pasurive dhe investimeve dhe një Njësi për Menaxhimin e rrezikut e cila kryen kontrollin sasior dhe cilësor të gjitha rreziqeve të lidhura me Fondin. Nuk lejohen të gjitha ato investimet, norma e kthimit e të cilave, është nën nivelin e tregut, sepse kjo do të rrezikojë ekuilibrin e lidhjes investime - rrezik.

8. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(e) Administrimi i rrezikut të kapitalit (vazhdim)***(iii) Investimet e lejuara (vazhdim)*

Pasqyra e structures së investimeve më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:

	Vlera në datën e raportimit	Si % kundrejt aktiveve totale të fondit %
Obligacione Qeveritare	18,265,928	70%
Boni Thesari	3,735,047	14%
Paraja dhe ekuivalentë të saj	4,139,902	16%
31 dhjetor 2022	26,140,877	100%

	Vlera në datën e raportimit	Si % kundrejt aktiveve totale të fondit
Obligacione Qeveritare	29,370,529	62%
Bono Thesari	13,083,608	28%
Marrëveshje riblerje	1,206,169	3%
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to	3,417,609	7%
31 dhjetor 2021	47,077,915	100%

9. Vlera e drejtë e instrumentave financiar*Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohet tek çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e shitësit. Vlera e drejtë e instrumenteve të tjera financiare përcaktohet përmes teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e skontimit të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ka çmime tregu dhe modelet e vlerësimit.

Qëllimi i teknikave të vlerësimit është të arrijë një matje me vlerën e drejtë që pasqyron çmimin që do të merret për të shitur aktivin ose paguar për të transferuar detyrimin në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Fondi e mat vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë, i cili reflekton rëndësinë e elementëve të përdorur në realizimin e vlerësimit, që shpjegohet si më poshtë:

- **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit të bazuara në elementet e vëzhgueshëm, në mënyrë direkte ose jo direkte (p.sh. që rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar nëpërmjet çmimeve të instrumenteve të ngjashëm të kuotuar në tregje aktive; çmimet e kuotuar të instrumenteve të njëjta ose të ngjashme në tregje jo shumë aktive; ose teknika të tjera vlerësimi, ku të gjithë elementet e rëndësishme vëzhgohen në mënyrë direkte ose jo direkte nga të dhënat e tregut.

Modelet e përdorura për të përcaktuar vleran e drejtë janë të vlefshme dhe të rishikuara periodikisht nga Shoqëria e administrimit. Inputet në modelet e shumëfishta përfshijnë të dhëna të vëzhgueshme, të tilla si shuma e fitimeve të kompanive të krahasueshme me portofolin e Fondit përkatës dhe të dhëna të pavrojtueshme, siç janë parashikimet e fitimeve për Fondin e portofolit. Në modelet e flukseve të mjeteve monetare të skontuara, inputet e pa vëzhgueshme janë flukset monetare të parashikuara të fondit përkatës të portofolit dhe primit të rrezikut për likuiditetin dhe rrezikun e kredisë që përfshihen në normën e skontimit. Menaxhmenti përdor modele për të rregulluar kthimet e vrojtuar të kapitalit për të pasqyruar strukturën e financimit të borxhit/kapitalit aktual të investimit me kapital të vlefshëm. Modelet kalibrohen nga testimi i prapambetur me rezultatet aktuale/daljet e arritura për të siguruar që rezultatet janë të besueshme.

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

9. Vlera e drejtë e instrumentave financiare (vazhdim)

Investimet në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur.

Tabela e mëposhtme analizon në kuadër të hierarkisë së vlerës së drejtë aktivet financiare të Fondit (në bazë të klasës) i matur me vlerën e drejtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

Të gjitha matjet e vlerës së drejtë të publikuara janë matje të vlerës së drejtë periodike.

Niveli 2	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktive financiare me VDAGJ	22,000,975	42,454,137
TOTALI	22,000,975	42,454,137

Për aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, vlerësimet përgatiten dhe rishikohen rregullisht nga vlerësimi i Menaxherit të Rrezikut, i cili raporton dhe i bën rekomandime Shoqërisë Administruese në baza mujore në përputhje me vlerësimet mujore që u jepen investitorëve. Menaxheri i rrezikut konsideron përshtatshmërinë e modelit të vlerësimit, të dhënat hyrëse kryesore si dhe rezultatin e vlerësimit duke përdorur metoda të ndryshme të vlerësimit dhe teknika përgjithësisht të njohura si standarde në kuadër të industrisë. Teknika e vlerësimit është zgjedhur dhe kalibruar në blerjen e titujve themelore të portofolit. Në përcaktimin e përshtatshmërisë të teknikës së zgjedhur të vlerësimit, Menaxheri i rrezikut mund të kryejë testimin përsëri duke marrë në konsideratë rezultatet aktuale të modeleve të ndryshme dhe se si ata historikisht janë në një linjë me transaksionet aktuale të tregut. Përveç kësaj, Banka e Kujdestarisë është përgjegjëse për rishikimin e rivlerësimeve përmes një procedure të konfirmimit ditor.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to përfshijnë paratë në dorë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankat rezidente. Duke qenë se këto balanca janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

10. Të ardhura nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv

Të ardhurat nga interesi i instrumentave financiare sipas kategorisë përbehen si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktive financiare me VDATGJ	1,315,949	1,473,840
Të ardhurat nga interesi i depozitave	15,314	603
Të ardhurat nga interesi i marrëveshjeve të riblerjes	21,736	6,944
Totali	1,352,999	1,481,387

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

11. Ndryshime në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse

Ndryshimet në vlerën e drejtë janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Fitime të realizuara në investime	2,157,046	400,737
Fitime të parealizuara në investime	(4,575,280)	(319,168)
Totali i ndryshimeve në vlerën e drejtë të aktiveve financiare	(2,418,235)	81,569

Viti 2022 ishte një vit sfidues për tregjet financiare dhe fondet tona gjithashtu. Rritja e ndjeshme e normave të interesit ndikoi në performancën negative të të gjitha investimeve në obligacione dhe roje aksionesh dhe kjo ka qenë e njëjtë në mbarë botën, jo vetëm për fondet që Raiffeisen investon nën menaxhim. Në tregun e brendshëm, gjatë vitit 2022 Banka e Shqipërisë rriti normën bazë nga 0.5% në 2.75% me synimin për ta çuar inflacionin më të lartë në nivelet e objektivit që ka Banka e Shqipërisë, i shoqëruar me norma më të larta interesi të Shqipërisë. titujt e qeverisë (ku investojnë fondet Prestige dhe Vision) me 3% në 4.2%.

12. Aktivët financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse

Aktivët financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Obligacione Qeveritare	18,265,928	29,370,529
Bono Thesari	3,735,047	13,083,608
Totali	22,000,975	42,454,137

13. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Llogaritë rrjedhëse me bankën kujdestare	2,556,934	31,602
Totali i llogarive rrjedhëse	2,556,934	31,602
Depozita		3,386,000
Repo	1,581,792.13	1,206,035
Interesi I përlllogaritur	1,176	141
Totali	1,582,968	4,592,176
Totali i parasë dhe ekuivalentët me to	4,139,902	4,623,778

Interesi i aplikuar në depozitat me afat varian nga 0.0%-2.25% (2021: 0.0% - 0.45%).

14. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera përfshijnë burimin në tatimit mbi të ardhurat personale që i paguhet organeve tatimore, të ardhura nga përfitimet e tërhequra nga mbajtësit e kuotave gjatë muajit dhjetor. Shoqëria administruese vepron si agjent grumbullues në emër të Fondit, sipas ligjit nr.8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998. Detyrimet për Bankën e Kujdestarisë, AMF, Audituesin dhe çdo kosto tjetër që lidhet me transaksionet e fondit investues sipas Ligji nr 56/2020 datë 30.04.2020.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrimet për organet tatimore	29,713	10,745
Tarifa e bankës depozitare	1,486	2,579
Tarifa rregullatore e pagueshme	1,150	1,994
Detyrime të tjera	1,332	134
Totali	33,681	15,452

Raiffeisen Prestigj

Shënime për pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(të gjitha vlerat janë në mijë Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

15. Aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktive neto që i atribuohen kontribuesve më 1 janar	46,961,787	42,110,544
Kontributet e emetuara gjatë vitit	4,669,654	11,063,599
Kontribute të tërhequra gjatë vitit	(24,075,440)	(7,257,596)
	<u>27,556,001</u>	<u>45,916,547</u>
Rritja në aktivet neto që i atribuohen mbajtësve të kuotave gjatë vitit	<u>(1,544,685)</u>	<u>1,045,240</u>
Gjëndja më 31 dhjetor	<u>26,011,316</u>	<u>46,961,787</u>
Aktivitet për njësi në Lek më 31 dhjetor	<u>1,510</u>	<u>1,574</u>

16. Palët e lidhura

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale.

Palët e lidhura të Fondit janë Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a, e cila menaxhon Fondin, banka kujdestare e Fondit dhe Raiffeisen Bank sh.a. si aksionar i vetëm i Shoqërisë Administruese.

Që nga dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 Fondi ka hyrë në transaksionet dhe balancat e mëposhtme me palët e lidhura me të.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Depozita		
Depozita ne Raiffeisen Bank	-	2,986,000
Interesi I llogaritur	-	-
	<u>-</u>	<u>2,986,000</u>
Detyrime ndaj Shoqërisë Administruese		
Tarifë e pagueshme ndaj Shoqërisë administruese	(26,287)	(45,643)
	<u>(26,287)</u>	<u>(45,643)</u>
Të ardhura		
Të ardhura nga interesat e depozitave	14,066	-
	<u>14,066</u>	<u>-</u>
Shpenzime		
Tarifa e Shoqërisë administruese	(467,701)	(548,248)
Totali	<u>(467,701)</u>	<u>(548,248)</u>

17. Ngjarjet pas dates së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që mund të kërkojnë korrigjim ose shpalesje shtesë në pasqyrat financiare.